

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO - SYRI TV/ Sterilizimi/ Lufta brenda qeverisë e hapur, tenderi u fitua pa garë nga
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916564/syri-tv-sterilizimi-lufta-brenda-qeverise-e-hapur-t-enderi-u-fitua-pa-gare-nga-diaverum/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 13:12:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 12:47:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	82717dc7d68cabb88440c21a4bf588984b3d18036a39362070afe81cb6632c69
TEKSTI	8daa329fd3e1de10734680f5752b874f4479ae5828a335206e31bd3349de3105
PAMJA	32e7d63030ae0d883a1c6104dc2937ded6ebd45958febfb0b86e8183f79b5fb3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0f789db66890171a3dd6334110adfb10262c4412709ced8f3e825077a678c380
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0b6439cf09af002acf6ffba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0f789db66890171a3dd6334110adfb10262c4412709ced8f3e825077a678c380>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën

LAJMI I FUNDIT

Apeli i GJKKO-së pranon kërkesën e Metës: Do gjykohej jashtë kafazit të qelqtë

më të lexuarat

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtësisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina



SYRI TV/ Sterilizimi/ Lufta brenda qeverisë e hapur, tenderi u fitua pa garë nga 'Diaverum'

14:47, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Ministrja e re e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu, sapo mori detyrën, shkarkoi drejtoreshën e Operatorit Shtetëror të Sterilizimit pak pasi përfundoi tenderi rreth 50 milionë euro për shërbimin e hemodializës, të fituar nga kompania suedeze "Diaverum". Por nga ana tjetër, Spahiu ka sinjalizuar edhe anulimin e tenderit të shumë debatuar, duke rritur mundësinë e një përplasjeje ligjore dhe politike brenda qeverisë.

SYRI TV

Ministrja e sapoemëruar e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu, e nisi punën e saj me shkarkimin e drejtoreshës së Operatorit Shtetëror të Sterilizimit, Arisa Cane, vetëm pak orë pasi ajo mbylli tenderin e shumëdebatuar për Shërbimin e Hemodializës, me vlerë rreth 50 milionë euro.

Ndërkohë që njoftoi emërimin e drejtoreshës së re, Yllka Sheta, ministrja la të kuptohet gjithashtu që do të anulohet procedurën e fituar nga kompania me seli në Suedi, "Diaverum".

Por, përtej deklaratave publike, situata në letra duket ndryshe dhe, me shumë mundësi, do të vijojë të krijojë përplasje brenda radhëve të qeverisë. Në Buletinin e Prokurimit Publik të kësaj të hëne, Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit ka publikuar njoftimin për shpalljen e "Diaverum" fitues të tenderit "Ofrimi i shërbimit të hemodializës në 5 (pesë) qendra të hemodializës, të ngritura në spitalet Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan, Marrëveshje Kuadër 48 muaj".

Kompania fituese ishte e vetme në garë dhe paraqiti ofertën në shumën 4.440.664.800 lekë të reja.

Ndërkohë, njoftimi i fituesit është shoqëruar edhe me një detaj të vogël, por që mund të ndozë çorrin brenda kabinetit të kryeministrit Edi Rama. Në dokumente

thuhet se: "Me publikimin e këtij njoftimi, nuk zbatohet periudha e pritjes për ankime, sipas përcaktimeve në shkronjën "b", pika 2, neni 96 'Periudha e pritjes' të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, 'Për Prokurimin Publik'".

Në këtë nen thuhet shprehimisht: "Periudha e pritjes, e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nuk zbatohet, në rastin e procedurave me një ofertues të vetëm, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues".

Në bazë të këtyre parashikimeve, kompania "Diaverum" rezulton se është shpallur përfundimisht fituese e tenderit 50 milionë euro.

Ndërkohë, ministria e re, Klodiana Spahiu, mbështet idenë e anulimit të procedurës, duke krijuar premisat për një përballje gjyqësore me shoqërinë fituese.

Tenderi dhe zhvillimet e fundit në Operatorin Publik të Sterilizimit, i njohur si OSISH, u shoqëruan me dyshime dhe akuza nga opozita. Kreu i Komisionit Parlamentar Shëndetësor, Bardh Spahia, deklaroi pak ditë më parë se e emëruara e re në krye të OSISH është një familjare e afërt e bashkëshortes së kryeministrit dhe u vendos aty për të kontrolluar miliardat e kësaj strukture.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Apeli i GJKKO-së pranon kërkesën e Metës: Do gjykohej jashtë kafazit të qelqtë



Mazhoranca refuzon përfshirjen në kalendar të nismës për shfuqizimin e 'Ligjit për Zonat e Mbrojtura'- Zhupa: Po mbronni korrupsionin



PD: Viti i ri shkollor nis me 4 mashtime nga qeveria, arsimi shqiptar në gjendje të rëndë dhe jashtë çdo standardi

i përket kësaj labele, po zbulohet historia



'Po blejnë influencë të zyrtarët e BE', Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës



SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin e tyre



'Diaspora nuk ka për tia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto

TË NGJASHME



A do mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike? Subashi i Fierit hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë



A do e lëshojë Rama, Ballukun? Berisha: Ka një tension real midis tyre pas arrestimit të Agasit



Berisha: Nuk kisha asgjë personale në përpjekjen time për një opozitë të pavarur. Kisha vetëm interes kombëtar



Keqkuptimi me takimet e së premtes!



Takimi me kryeprokurorin e SHBA/ Berisha: Paraqitëm problemet më kryesore të lidhura me shtetin ligjor dhe narkoshtetin



Berisha: Nuk kam qenë kurrë 'non grata'! Ata që u morën me këtë çështje kanë marrë ndëshkimin e merituar, nga McGonigal te Yuri Kim e Blinken



Berisha: Denoncoj me forcën më të madhe kërcënimet ndaj gruas dhe familjarëve të Ahmetajt me urdhër të Ramës

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net